



Llywodraeth Cymru
Welsh Government

Testo. Gjurmo. Mbro.


Për ta mbajtur Uellsin të sigurt.



Çfarë duhet të bëni?

1

Ju shfaqet të paktën 1 simptomë e koronavirusit: kollë e vazhdueshme; temperaturë e lartë; ose humbje e ndjesisë së shijes dhe njuhates.



Nëse keni qëndruar në distancë më të afërt se 1 m nga dikush për 1 minutë ose më gjatë ose në distancë më të afërt se 2 m nga dikush për 15 minuta ose më gjatë, do të duhet të na tregoni për ta. Ju gjithashtu duhet të na tregoni për këdo që keni udhëtuar së bashku në një automjet, ose për njerëzit që janë ulur afër jush në transportin publik.

Ju lutemi tregohuni vigjilentë për telefonuesit mashtrues. Ne kurrë nuk do t'ju kërkojmë ndonjë informacion financiar, detaje bankare ose fjalëkalime. Nëse keni dyshime, mos jepni informacione. Mesazhet do të dërgohen nga +447775106684, emaillet do të dërgohen nga tracing@wales.nhs.uk / olrhain@wales.nhs.uk, si dhe thirrjet telefonike do të bëhen nga 02921 961133. Asnjë kanal tjetër nuk do të përdoret nga ekipi NHS Trace, Test, Protect.

2

Ju dhe anëtarët e familjes tuaj ndiqni udhëzimet për vetëizolim.



3

Bëni një test brenda 5 ditëve të para të shfaqjes së simptomave, kur testi është më efektiv. Aplikoni për testim këtu.

4

Nëse testi del negativ, nuk është i nevojshëm asnjë veprim i mëtejshëm nga ju ose të tjerët në shtëpi. Nuk keni më nevojë të vetëizoloheni. Nëse testi del pozitiv, do të kontaktoheni nga një gjurmues kontakti në emër të shërbimit NHS Wales Test, Trace, Protect. Do të kontaktoheni vetëm pasi testi t'ju ketë rezultuar pozitiv.



6

Një gjurmues kontakti do të kontaktojë personat me të cilët keni pasur kontakt. Gjurmuesit do t'ju thonë atyre që kanë qenë në kontakt me dikë që ka rezultuar pozitivisht për koronavirus. Identiteti juaj nuk do të zbulohet nëse nuk jepni leje. Atyre do t'ju ofrohet mbështetje dhe këshillim se si të vetëizolohen për 14 ditë nga kontakti i tyre i fundit me ju. Anëtarëve të familjeve të tyre nuk do t'ju kërkohej të vetëizolohen, por duhet të ndjekin udhëzimet e distancimit social dhe të shmangin kontaktin me personin i cili izolohet në shtëpi.



5

Do t'ju kërkohej të na jepni informacione. Do të duhet të dimë me kë keni qenë në kontakt dhe ku keni qenë dy ditë para fillimit të shfaqjes së simptomave deri tani.



7

Personat me të cilët keni pasur kontakt do të këshillohen të bëjnë testin vetëm nëse shfaqin simptoma. Testimi i personave asimptomatikë nuk rekomandohet pasi mund të gjenerojë teste negative të rreme. Nëse ata rezultojnë pozitivë, procesi do të përsëritet për këta persona si dhe për anëtarët e tyre të familjes dhe të personave me të cilët kanë kontaktuar.

GJURMONI LËVIZJET TUAJA. NDALONI PËRHAPJEN.
SË BASHKU DO TA MBAJTMË UELLSIN TË SIGURT.

Vizitoni gov.wales/coronavirus

